



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MBROJTJES**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE**

**FTESË PËR OFERTË**

Titulli i projektit: Fuqizimi i Reziliencës Shqiptare përmes bashkëzbatimit të një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm ndaj Shumë Rreziqeve (EAR-MHEWS)  
Nr. i Projektit: 21.2314.9-004.00  
Vendi: Shqipëri

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është një agjenci në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë (ministra përgjegjëse për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar). AKMC ushtron funksione koordinuese, mbikëqyrëse teknike, drejtuese dhe kontrolluese në fushën e reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile. Qëllimi i mbrojtjes civile është reduktimi i riskut nga fatkeqësitë dhe garantimi i mbrojtjes së jetës së njerëzve, gjallesave, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, përmes forcimit të sistemit të mbrojtjes civile, përcaktimit të përgjegjësive të institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimit ndërkombëtar, të drejtave dhe detyrimeve të qytetarëve dhe subjekteve private, edukimit, trajnimit dhe inspektimit.

Projekti “Fuqizimi i Reziliencës Shqiptare përmes bashkëzbatimit të një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm ndaj Shumë Rreziqeve (EAR-MHEWS)” zbatohet nga AKMC dhe partnerët kombëtarë, me qëllim krijimin e një sistemi funksional paralajmërimi të hershëm ndaj shumë rreziqeve, i cili adreson për herë të parë rreziqe të shumta klimatike në mënyrë të strukturuar, të koordinuar dhe të integruar. Shtrirja gjeografike e sistemit do të jetë kombëtare, megjithëse nevojat specifike sipas rreziqeve do të ndryshojnë sipas zonave gjeografike; për shembull, përmbytjet janë më të theksuara në zonat bregdetare të rrezikuara nga përmbytjet.

Ky projekt është pjesë integrale e Programit “Zhvillim Urban Rezilient ndaj Klimës në Shqipëri – ALBAdapt”, bashkëfinancuar nga Green Climate Fund (GCF).

Fusha kryesore e programit ALBAdapt është përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. ALBAdapt synon të rrisë reziliencën klimatike të popullsisë shqiptare përmes krijimit, koordinimit dhe përdorimit efektiv të informacionit klimatik – të mbështetur nga një shërbim funksional meteorologjik dhe hidrologjik kombëtar (NMHS) dhe Korniza Kombëtare për Shërbimet Klimatike (NFCS) – si dhe nga një sistem paralajmërimi të hershëm ndaj shumë rreziqeve me në qendër qytetarin (MHEWS), të cilat së bashku përbëjnë një sistem të integruar informacioni klimatik dhe paralajmërimi të hershëm (CIEWS).

ALBAdapt përbëhet nga 3 komponentë si më poshtë:

- Komponenti 1 – Shërbimet meteorologjike, hidrologjike dhe klimatike;
- Komponenti 2 – Sistemet e paralajmërimit të hershëm ndaj shumë rreziqeve dhe veprimi i hershëm;
- Komponenti 3 – Vendimmarrja për investime të informuara nga klima.



Në kuadër të këtij projekti, synohet zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje automjetesh”**, në përputhje me Specifikimet Teknike bashkëlidhur.

Ju lutemi referojuni “Specifikimeve Teknike” (Shtojca 1) për informacion të detajuar.

Afati i dorëzimit dhe etiketimi i ofertës

Nëse jeni të interesuar për furnizimin e mallrave në përputhje me Specifikimet Teknike bashkëlidhur, ju ftojmë të paraqisni ofertën tuaj në një origjinal pranë AKMC-së deri më datë 07.07.2026 ora 16.00.

Ju lutemi adresoni ofertën tuaj në:

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)  
Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Godina nr. 36  
Tiranë, Shqipëri

Nëse keni pyetje të mëtejshme lidhur me tenderin, lutemi kontaktoni vetëm në adresën [info.ear-mhews@akmc.gov.al](mailto:info.ear-mhews@akmc.gov.al) pranë zyrës së AKMC-së. Ju lutemi vini re se pyetjet do të pranohen vetëm brenda shtatë (7) ditëve nga data e publikimit të procedurës së prokurimit.

Ofertat duhet të dorëzohen sipas procedurës me dy zarfe:

- a. Propozimi Teknik (përfshirë të gjithë dokumentacionin administrativ dhe dokumentet e kualifikimit);
- b. Oferta Financiare.

Secila pjesë duhet të vendoset në një zarf të veçantë, të mbyllur. Propozimi Teknik nuk duhet të përmbajë informacion financiar.

Të dy zarfet duhet të vendosen më pas në një zarf të jashtëm të mbyllur, të etiketuara qartë si më poshtë:

- Emri i procedurës së prokurimit:  
**“Blerje automjetesh”**
- Emri dhe adresa e ofertuesit
- “Mos e hapni përpara seancës zyrtare të hapjes së ofertave”

Dokumentet e ofertës

Titulli i projektit: Fuqizimi i Reziliencës Shqiptare përmes bashkëzbatimit të një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm ndaj Shumë Rreziqeve (EAR-MHEWS)  
Nr. i Projektit: 21.2314.9-004.00

Oferta financiare për tenderin

Titulli i projektit: Fuqizimi i Reziliencës Shqiptare përmes bashkëzbatimit të një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm ndaj Shumë Rreziqeve (EAR-MHEWS)  
Nr. i Projektit: 21.2314.9-004.00



Zarfet duhet të dorëzohen në protokollin e institucionit deri më datë 07.07.2026 ora 16.00, e cila përbën afatin e fundit për dorëzimin e ofertave.

#### Përmbajtja e ofertës

Të gjitha kopjet e ofertës duhet të paraqiten në formë të shkruar.

Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të tregojë anëtarët pjesëmarrës dhe mënyrën e ndarjes së punëve ndërmjet tyre. Konkretisht, të gjithë anëtarët duhet të përcaktojnë operatorin kryesor dhe ta autorizojnë atë për të përfaqësuar bashkimin dhe për të marrë pagesat në emër të anëtarëve të tjerë. Gjithashtu, anëtarët duhet të pranojnë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare për zbatimin e kontratës. Një autorizim përkatës me shkrim duhet t'i bashkëlidhet ofertës. Oferta duhet të paraqitet në gjuhën e dokumenteve të tenderit.

Ofertat do të mbeten të vlefshme për 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga afati i dorëzimit të ofertave.

Oferta teknike duhet të përmbajë një propozim teknik të detajuar në përputhje me Specifikimet Teknike.

#### Përmbajtja e ofertës financiare

Oferta financiare duhet të përfshijë çmimet për njësi për mallrat dhe çmimin total, duke përfshirë të gjitha kostot e aplikueshme, në monedhën vendase, sipas Shtojcës 2 (Formulari i Çmimeve). Ju lutemi llogaritni çmimet mbi bazë bruto. Ofertuesit duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe kualifikimit sipas kërkesave të përcaktuara në Shtojcën 5.

Vlerësimi i ofertës financiare do të kryhet pas hapjes së zarfit të ofertës teknike.

#### Vlerësimi i ofertave

Procesi i vlerësimit parashikohet të përfundojë deri më 17.07.2026 dhe do të zhvillohet në dy faza:

- Verifikimi i përputhshmërisë me kërkesat administrative, të pranueshmërisë dhe teknike;
- Vlerësimi i ofertave financiare.

Vetëm ofertat që plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara do të konsiderohen për vlerësim financiar.

Çdo përpjekje nga një ofertues për të ndikuar procesin e vlerësimit, për të siguruar informacion konfidencial, ose për t'u përfshirë në praktika mashtruese, korruptive, bashkëpunuese, shtrënguese apo penguese, do të rezultojë në përjashtimin e menjëhershëm nga procedura e prokurimit.

Kontrata do t'i jepet ofertuesit që paraqet ofertën financiare më të ulët ndër ofertat që plotësojnë të gjitha kërkesat teknike dhe administrative.



Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktor nxjerr vendimin për qëllim shpallje fituesi, duke identifikuar operatorin ekonomik të renditur i pari sipas metodologjisë së vlerësimit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Përpara përfundimit të afatit të ankimimit, Autoriteti Kontraktor do të nxjerrë një vendim të synuar për shpalljen e fituesit dhe do të njoftojë ofertuesit pjesëmarrës në përputhje me këtë vendim.

Kontrata do të nënshkruhet vetëm pas përfundimit të afatit të ankimimit ose pas marrjes së një vendimi përfundimtar për çdo ankesë të paraqitur.

Fillimi i kontratës / Dorëzimi

Dorëzimi i mallrave duhet të përfundojë brenda 4 (katër) muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Ankesat dhe sqarimet

Kërkesat për sqarim lidhur me dokumentet e tenderit mund të paraqiten me email brenda shtatë (7) ditëve nga data e publikimit.

Çdo ofertues që konsideron se nuk është trajtuar në mënyrë të drejtë gjatë procesit të vlerësimit mund të paraqesë një ankesë me shkrim brenda pesë (5) ditëve nga njoftimi i rezultateve.

Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe ankesat dhe do të përgjigjet në të njëjtën formë në të cilën ato janë paraqitur, përkatësisht me email për kërkesat për sqarim dhe me përgjigje zyrtare me shkrim për ankesat formale.

Kontrata mund të lidhet pas përfundimit të afatit të ankimimit ose pas marrjes së një vendimi përfundimtar për çdo ankesë të paraqitur.”

Paraqitja e kërkesave për sqarim ose ankesave nuk pezullon procedurën e prokurimit.

Me respekt,

**AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE (AKMC)**

Shtojcat:

1. Specifikimet Teknike
2. Formulari i Çmimeve
3. Deklarata mbi Konfliktin e Interesit
4. Deklarata mbi Kriteret e Përfundimit
5. Kriteret e Kualifikimit dhe Pranueshmërisë